



## VENDIM PËR PAPANUESHMËRI

**Data e miratimit:** 23 nëntor 2011

**Numri i lëndës** 2011-01

**Familja e z. Dedë Gecaj**

**Kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 23 nëntor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues  
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore  
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PARA PANELIT**

1. Ankesa është parashtruar nga një avokat që vepron në emër të familjes së z. Dedë Gecaj-t. Ankesa është regjistruar më 11 janar 2011.

## II. FAKTET

2. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi i ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve në dispozicion të Panelit, mund të përmbliidhen si në vijim.

### *Informatat paraprake*

3. Z. Dedë Gecaj dhe familja e tij kanë jetuar në Zvicër që prej 1 prillit të vitit 1991. Më 11 janar 1999 z. Gecaj supozohet se kishte vrarë mësuesin e vajzës së tij 14 vjeçare në Zvicër. Shumë shpejt pas kësaj ai ishte kthyer në Kosovë.
4. Më 2 shtator 2010 z. Gecaj ishte ekstraduar në Zvicër. Ai kishte vdekur atje në burg më 18 nëntor 2010.

### *Hetimi penal në Jugosllavi*

5. Më 25 shkurt 1999 z. Gecaj ishte arrestuar në Pejë dhe ishte akuzuar sipas Ligjit të Procedurës Penale të Republikës Federative të Jugosllavisë.
6. Më 1 mars 1999 ai ishte paraqitur para Gjykatës së Qarkut të Pejës dhe kishte mbetur në paraburgim.
7. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (më tutje: "KSKB") që themelon Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (më tutje: "UNMIK") ishte miratuar më 10 qershor 1999.
8. Më 27 shtator 1999 Gjykata Supreme e Republikës së Serbisë kishte ndërruar vendin e mbajtjes së seancave në Gjykatën e Qarkut të Leskovcit për lehtësimin e procedurave siç lejohet me ligj.
9. Autoritetet zvicerane dhe jugosllave kishin bashkëpunuar rreth kësaj çështje, duke lejuar Gjykatën e Qarkut të Leskovcit dhe të gjitha palët të kenë qasje në provat e mbledhura në Zvicër si dhe të zhvillojnë veprime procedurale, siç është dëgjimi i katërbëdhjetë (14) dëshmitarëve dhe ekspertëve në Zvicër në nëntor 2000.

### *Procedurat penale në Gjykatën e Qarkut të Leskovcit dhe në Gjykatën Supreme të Republikës së Serbisë.*

10. Më 7 dhjetor 2000 Gjykata e Qarkut të Leskovcit shpalli z. Gecaj fajtor për vrasje sipas Nenit 47 të Kodit Penal të Serbisë. Ai ishte dënuar katër vite e gjysmë në burg. Ai ishte liruar nga paraburgimi më 7 dhjetor 2000, në pritje të vendimit përfundimtar nga Gjykata Supreme e Republikës së Serbisë. Z Gecaj nuk ishte kthyer që ta vuaj pjesën e mbetur të dënimit.
11. Gjykata Supreme e Republikës së Serbisë ka vërtetuar vendimin e 22 marsit 2002.

12. Më 28 maj 2003 dënimi ishte zbutur në tre vite e gjashtë muaj burg duke llogaritur kohën e qëndrimit në paraburgim nga data 27 shkurt e deri më 7 dhjetor 2000.

*Procedurat e ekstradimit*

13. Më 19 maj 2003 dhe më 6 dhjetor 2005 gjyqtari hetues në Zvicër kishte lëshuar një urdhër arrest ndaj z. Gecaj. Ai dyshohej që kishte kryer vrasjen e lartpërmendur më lart midis viteve 1995 dhe 1996, dhe përveç kësaj me gjasë edhe vrasje me paramendim, akte seksuale me një fëmijë, lëndime të shumta trupore, dhunime të shumta, detyrime të shumta, akuza të rreme dhe/apo nxitje, dhunë dhe kërcënime kundër autoriteteve dhe zyrtarëve dhe një akt i ndëshkueshëm përgatitor për vrasje me paramendim ose rrëmbim, të gjitha të dënueshme sipas Kodit Penal të Zvicrës.
14. Më 22 shkurt 2006 ishte kryer një marrëveshje ndërkombëtare midis Zvicrës dhe UNMIK-ut lidhur me ekstradimin/transferin e z. Gecaj.
15. Më 6 mars 2006 autoritetet zvicerane kanë kërkuar transferin e z. Gecaj për në Zvicër. Procedurat e transferim kishin nisur më 16 mars 2006 nga autoritetet zvicerane.
16. Z. Gecaj ishte arrestuar më 4 maj 2006 në Kosovë, mirëpo të njëjtën ditë ishte liruar pas një vendimi të një gjykatësi të procedurës paraprake të UNMIK-ut.
17. Më 7 maj 2006, me kërkesë të prokurorit, trupi gjyqësor i UNMIK-ut në Gjykatën e Qarkut në Pejë kishte urdhëruar që z. Gecaj të paraburgoset. Z. Gecaj më në fund ishte arrestuar pas më shumë se një viti, më 13 gusht 2007.
18. Më 20 gusht 2007, një marrëveshje e re lidhur me ekstradimin/transferin e z. Gecaj ishte nënshkruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB (më tutje: PSSP) dhe Ministrin Federal zviceran të Punëve të Jashtme. Marrëveshja ishte bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2003/34, Nenit 2 dhe 3, që zbatohen për "vepër penale të kryer para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje e cila do të përbënte vepër penale në kohën e kryerjes së tyre".
19. Më 3 shtator 2007 gjykatësi i procedurës paraprake të UNMIK-ut i Gjykatës së Qarkut në Pejë kishte vendosur sipas Nenit 521 të Kodit të Procedurës së Përkohshme të Kosovës (më tutje si: KPPPK) se parakushtet për transferim për në Zvicër ekzistonin për veprat e supozuara të vrasjes, lëndimeve të shumta trupore, dhunime të shumta, dhunë dhe kërcënime kundër autoriteteve dhe zyrtarëve dhe veprën përgatitore për vrasje me paramendim. Këto ishin të njëjta akuza për të cilat ishte vërtetuar paraburgimi më 17 gusht 2007 (shih paragrafin 34 më poshtë).

20. Më 5 nëntor 2007 një trup gjykues i përbërë prej tre gjyqtarëve të UNMIK-ut në Gjykatën e Qarkut të Pejës kishte pranuar petitionin për transferimin e z. Gecaj për në Zvicër për të gjitha veprat kriminale që dyshohej se i kishte kryer z. Gecaj, përfshirë gjithashtu vrasjen me paramendim dhe aktet e shumta seksuale me një fëmijë.
21. Më 28 mars 2008 Gjykata Supreme e Kosovës kishte hedhur poshtë petitionin për transferim për në Zvicër sipas Nenit 434 të KPPPK. Gjykata kishte argumentuar se në atë kohë kur kishin ndodhur krimet e dyshuara, z. Gecaj ishte shtetas i Serbisë dhe në bazë të ligjit më të favorshëm për të pandehurin, ai kishte të drejtë që mos të ekstradohej nga Jugosllavia, e që ishte pranuar nga Kushtetuta e Ish Republikës Federative të Jugosllavisë (IRFJ) dhe Republikës së Serbisë. Për më tepër, në atë kohë nuk kishte pasur ndodhë marrëveshje për ekstradim në mes të IRFJ dhe Zvicrës. Prandaj z. Gecaj nuk mund të ekstradohej.

*Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë*

22. Më 24 korrik 2008 prokurori publik ka paraqitur një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, bazuar në Nenin 457 të KPPK, kundër vendimit përfundimtar të Gjykatës Supreme të Kosovës së datës 28 mars 2008. Prokurori ka kërkuar që kushtetutat e përmendura nuk ishte në fuqi në Kosovë dhe se nuk ka pasur asgjë për ta penguar transferin e z. Gecajt në Zvicër.
23. EULEX-i mori përgjegjësinë nga UNMIK-u këtë lëndë në dhjetor 2008, atëherë kur EULEX-i u bë operativ. Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it ka vendosur që ta mbaj rastin nën përgjegjësinë e gjykatësve të EULEX-it në përputhje me Nenin 16.2 të Ligjit për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053, më tutje si: "Ligji mbi kompetencat").
24. Më 6 prill 2009 Gjykata Supreme e Kosovës në një trup gjykues të përzier të EULEX-it dhe gjykatësve vendorë, ka miratuar kërkesën e prokurorit duke nxjerr në përfundim se vendimi i mëhershëm i datës 28 mars 2008 kishte shkelur ligjin duke pohuar se kushtetutat e IRFJ dhe Republikës së Serbisë ishin në fuqi në Kosovë dhe si e tillë kishte penguar ekstradimin e z. Gecaj.
25. Gjykata *ndër të tjerash* ka deklaruar se kur procedura e ekstradimit për transferin e z. Gecaj kishte filluar, Kushtetutat e IRFJ dhe Republikës së Serbisë nuk ishin në fuqi në Kosovë. Të dyja këto kushtetuta ishin zëvendësuar nga Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të përkohshme (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, e cila nuk kishte përfshirë ndonjë të drejtë të një shtetasi që mos të ekstradohet), Rregullorja e UNMIK-ut 2003-26, Rregullorja e UNMIK-ut 2003-34 dhe KPPPK. Neni 533 i KPPPK kishte lejuar transferimin e banorit të Kosovës atëherë kur ky transfer i këtij personi të ishte lejuar nga një marrëveshje ndërkombëtare dhe atëherë kur parakushtet të ishin plotësuar për një transfer të përcaktuara në Nenin 517 të KPPK.

Një marrëveshje ndërkombëtare u arrit më 20 gusht 2007 në mes të UNMIK-ut dhe Zvicrës.

26. Më 22 qershor 2009 z. Gecaj kishte paraqitur një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të datës 6 prill 2009. Më 22 korrik 2009 Gjykata Supreme kishte hedhur poshtë kërkesën e tij, sipas Nenit 451 të KPPPK, një kërkesë e tillë nuk mund të paraqitet kundër një vendimi të Gjykatës Supreme në të cilën tashmë ishte vendosur rreth një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

#### *Procedurat para Gjykatës Kushtetuese*

27. Më 22 qershor 2009 z. Gecaj kishte kërkuar që Gjykata Kushtetuese ta shfuqizoj vendimin e Gjykatës Supreme të datës 6 prill 2009. Ai pohon ndër të tjerash se parimi i “*ne bis in idem*”<sup>1</sup> ishte shkelur atëherë kur Gjykata Supreme nuk kishte marrë parasysh vendimin përfundimtar në rastin e tij nga Gjykata Supreme e Serbisë në vitin 2002.
28. Përpos kësaj, më 17 shtator 2009 z. Gecaj kishte kërkuar masë të përkohshme, pra pezullimin e procedurës për transferimin e tij për në Zvicër. Kjo kërkesë për masë të përkohshme ishte hedhur poshtë më 15 dhjetor 2009.
29. Më 20 maj 2010 Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën e z. Gecaj të papranueshme duke deklaruar që varej nga z. Gecaj se a do ta ngrit çështjen e “*ne bis in idem*” tek autoritetet e Zvicrës kur ishte transferuar në Zvicër. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka gjetur se ekstradimi mund të hedhet poshtë në rrethanat ku parashtruesi i kërkesës ka vuajtur apo rrezikon të vuaj nga ndonjë mohim i dukshëm i së drejtës për gjykim të drejtë në shtetin ku paraqitet kërkesa”. Nuk është paraqitur ndonjë provë nga z. Gecaj se transferimi i tij do të bënte që ai t’i nënshtrohej një rreziku të tillë në Zvicër.

#### *Procedurat lidhur me paraburgimin*

30. Gjatë procedurave të tij para Gjykatës së Qarkut të Leskovcit, z. Gecaj ishte liruar nga paraburgimi më 7 dhjetor 2000, në pritje të vendimit përfundimtar nga Gjykata Supreme e Republikës së Serbisë. Ai asnjëherë nuk ishte kthyer në paraburgim, e as nuk e kishte vuajtur dënimin.
31. Bazuar në kërkesën për transferim nga autoritetet e Zvicrës dhe pastaj nga marrëveshja *lidhur me rastin* (shih paragrafët 14 dhe 15 më lart) z. Gecaj ishte arrestuar më 4 maj 2006 në Kosovë, mirëpo ai ishte liruar në të njëjtën ditë bazuar në një vendim të një gjykatësi të procedurës paraprake të UNMIK-ut.
32. Më 7 maj 2006, me kërkesë të prokurorit, trupi gjykues i UNMIK-ut në Gjykatën e Qarkut të Pejës kishte urdhëruar që z. Gecajt të

---

<sup>1</sup> “Askush nuk do të gjykohet për më shumë se një herë për veprën e njëjtë penale”.

paraburgoset. Z. Gecaj më në fund ishte arrestuar më shumë se një vit më vonë më 13 gusht 2007.

33. Më 17 gusht 2007, në kërkesën e mbrojtjes, trupi gjykues në përbërje të tre gjyqtarëve të UNMIK-ut të Gjykatës së Qarkut të Pejës kishin ndërprerë paraburgimin sa i përket krimeve për vrasje, akuzë të rreme dhe detyrime të shumta. Paraburgimi ishte vërtetuar për veprat e tjera penale që dyshohej se janë kryer nga z. Gecaj.
34. Pas një kërkesë nga prokurori publik më 28 mars 2008, paraburgimi i z. Gecaj kishte vazhduar nga Gjykata e Qarkut të Pejës më 31 mars 2008. Ai ishte liruar për në arrest shtëpiak më 8 korrik 2008 e që iu kishte vazhduar deri më 23 shtator 2008. Arresti shtëpiak më vonë iu ishte hequr më 4 shtator 2008 dhe parashtuesi i ankesës ishte liruar.
35. Më 12 maj 2009 një prokuror i EULEX-it kishte lëshuar një urdhër për arrestimin e z. Gecajt.
36. Më në fund ai u arrestua një vit më vonë, më 17 maj 2010, dhe një ditë më vonë një gjykatës i procedurës paraprake kishte urdhëruar që ai të paraburgosej.
37. Më 24 maj 2010, trupi gjykues në përbërje të tre gjykatësve kishte hedhur poshtë kërkesën e tij dhe kishin urdhëruar që ai të paraburgoset për një periudhë prej një muaji, nga arrestimi i tij deri më 17 qershor 2010. Sipas vendimit, autoritetet e Zvicrës kishin afat tre muaj të kërkonin transferimin e tij në Zvicër.
38. Më 16 qershor 2010 Gjykata e Qarkut e Pejës ia kishte zgjatur atij paraburgimin deri më 17 gusht 2010.

#### *Procedurat e fundit për transferim*

39. Më 17 qershor 2010 Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës kishte dorëzuar tek Gjykata e Qarkut të Pejës një kërkesë të re prej autoriteteve të Zvicrës që kërkonin ekstradimin e z. Gecaj.
40. Më 14 korrik 2010 Gjykata e Qarkut e Pejës kishte miratuar vendimin për transferim në lidhje me veprën e dyshuar penale të vrasjes, vrasje me paramendim, akte të shumta seksuale me një fëmijë dhe dhunime të shumta. Kërkesa për transferim ishte hedhur poshtë për pjesën tjetër të veprës penale të dyshuar për shkak të statusit të kufizimeve. Përveç kësaj ishte vendosur se z. Gecaj duhet të mbahej në paraburgim deri në transferimin e tij për në Zvicër.
41. Më 16 gusht 2010 Gjykata Supreme e Kosovës kishte hedhur poshtë kërkesën e z. Gecaj kundër vendimit të 14 korrikut 2010.
42. Më 2 shtator 2010 z. Gecaj ishte ekstraduar në Zvicër. Ai vdiq më 18 nëntor 2010 në burg.

### III. LEGJISLACIONI PËRKATËS

43. Neni 16, paragrafi 2 i Ligjit mbi kompetenca thotë si në vijim:

Kryeprokurori i EULEX-it dhe Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të vendosin në pajtim me këtë ligj se cilat nga lëndët e dorëzuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të jetë në kompetencë të gjyqtarëve përkatësisht prokurorëve të misionit të EULEX-it, dhe të cilat lëndë, për arsye të bazuara, do të mbesin në kompetencë të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it pasi që ato të kenë qenë në kompetencë të gjyqtarëve ndërkombëtarë të UNMIK-ut apo prokurorëve ndërkombëtarë të UNMIK-ut.

### IV. ANKESAT

44. Pjesa e parë e ankesës në fakt pohon se EULEX-i në Kosovë është përgjigjes për vdekjen e z. Gecaj. Sipas parashtruesit të ankesës, z. Gecaj ishte ekstraduar në Zvicrës në kundërshtim me parimet përkatëse të ligjit ndërkombëtarë dhe të drejtave të njeriut, kornizës ligjore në fuqi në Kosovë dhe vendimeve përfundimtare të Gjykatës Supreme të Kosovës në vitin 2008 dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Serbisë në vitin 2002. Vendimi për ekstradim ishte marrë nga gjykatësit e EULEX-it. Parashtruesi i ankesës kërkon që të gjithë gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës dhe EULEX-it të përfshirë gjatë fazave të ndryshme të procedurave të ndiqen penalisht për vepra penale që dyshohet se i kanë kryer.
45. Pjesa e dytë e ankesës lidhet me vdekjen e z. Gecaj në një burg në Zvicër dhe gjithashtu lidhet me procedurat e ndryshme administrative dhe ligjore pranë autoriteteve zvicerane sa i përket atij dhe disa anëtarëve të tij të familjes.

### V. LIGJI

46. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të RrP.
47. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1 i Rregullores së Punës, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
48. Sipas Rregullës të përmendur më lart, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtojë procedurat ligjore të gjykatave të Kosovës. Në veçanti, nuk është funksion i tij që të merret me gabimet e faktit apo ligjit që supozohet të jenë kryer nga gjykatat vendore, përveçse apo në atë masë sa ata do të kishin shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut i zbatueshëm në Kosovë.
49. Paneli konstaton se në pjesën e parë të ankesës, parashtruesi i ankesës kërkon që të ngritët padi penale kundër gjykatësve dhe

prokurorëve të Kosovës dhe të EULEX-it që ishin përfshirë në këtë rast.

50. Kjo pjesë e kësaj ankese lidhet me procedurat ligjore të kryera nga gjykatat e Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues që janë të caktuar për ta shqyrtuar rastin nuk do të thotë se ia humb gjykatave karakterin e tyre si pjesë të sistemit juridik të Kosovës.
51. Për më tepër, Paneli nuk ka kompetenca as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës dhe legjislacionin që zbatohet nga to. Vendimet e gjykatave të Kosovës i nënshtrohen ankesave dhe ekzistojnë mjete të jashtëzakonshme juridike sipas ligjit në fuqi. Të gjitha mjetet juridike janë shterur rreth rastit në fjalë.
52. Si pasojë, çështja që ngritët në pjesën e parë të ankesës nuk bie brenda mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë siç janë të përcaktuar në Rregulloren 25 të Rregullores së Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.
53. Pjesa e dytë e ankesës lidhet me trajtimin e z. Gecaj dhe anëtarëve të tij të familjes në Zvicër nga autoritetet zvicerane. Paneli konstaton se nuk ka juridiksion mbi procedurat që janë zhvilluar jashtë Kosovës.

#### **PËR KËTO ARSYE, PANELI, NJËZËRI**

*Konstaton* se nuk ka kompetenca për ta shqyrtuar ankesën,

*konstaton* se ankesa është e pabazuar sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së Punës së vet, dhe

#### **SHPLL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO  
Kryesues i Panelit